



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Rektori

Nr. 2300 Prot

Shkodër, më 16 . 07 .2018

UDHËZIM

Nr. 279 , datë 16 . 07 . 2018

Në mbështetje të ligjit nr. 80, datë 22. 07. 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në institucionit e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 25, udhëzimit nr 18. datë 21.05.2018 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2018-2019", Udhëzim nr.22, datë 20.06.2018 Për një ndryshim në udhëzimin nr 18. datë 21.05.2018 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2018-2019" :

UDHËZOJ:

**1. Krijimin e Komisioneve të Departamenteve për renditjen e aplikantëve.**

- a) Departamentet krijojnë komisione të përberë nga jo më pak se 3 (tre) anëtarë.
- b) Drejtori i Departamentit, i cili njëkohësisht është edhe kryetar i komisionit, i propozon Dekanit të fakultetit përkatës përbërjen e komisionit.
- c) Dekani miraton krijimin e komisionit dhe ia dërgon Rektorit deri me datë 20.07. 2018.
- d) Komisionet e departamenteve brenda datës 24 gusht 2018 duhet të deklarojnë pamundësinë e renditjes së kandidatëve në bazë të kriterëve të hartuara nga departamenti.

**2. Krijimin e Komisioneve të konkurseve për programet e studimit që zhvillohet konkurs.**

- a) Departamentet, në të cilët pranimi i studentëve bëhet më konkurs, i propozojnë dekanit të fakultetit përbërjen e komisionit.
- b) Dekani i fakultetit përkatës miraton përbërjen e komisionit të konkursit dhe ia dërgon Rektorit.

**3. Krijimin e Komisionit institucional për renditjen e studentëve bazuar në kriteret miratuara nga Senati Akademik.**

- a- Rektori kur departamentet deklarojnë pamundësinë e renditjes së kandidatëve, me propozim të Drejtorisë së IT-së dhe departamentit Matematikë - Informatikë formon komisionin me datë 25 gusht 2018.
- b- Detyrat e komisionit përcaktohen në urdhrin e krijimit të nxjerrë nga Rektori.

**4 Dekanët e Fakulteteve të sigurojnë prezencën në punë të anëtarëve të komisioneve të departamenteve dhe anëtarëve të grupit teknik në nivel fakultetit për regjistrimin e kandidatëve të shpallur fitues që nga 30 gusht deri me 20 tetor 2018.**

- a) Dekani i Fakultetit të Shkencave të Edukimit të urdhërojë dhe të sigurojë prezencën në punë të stafit ndihmës akademik të regjistrimit me datat 14/15/16 gusht 2018 për programin e studimit Pikturë - Grafikë dhe Pedagogji Muzikore dhe me datat 15/16/17/18 /20 gusht 2018 për Programin e studimit Edukim Fizik dhe sporte për regjistrimin e aplikantëve.
- b) Drejtorja e IT-se të urdhërojë dhe sigurojë prezencën në punë të personelit staf teknik për publikimin online të listave të studentëve pjesëmarrës në konkurs.

**5. Regjistrimi i Studentëve në degët ku zhvillohet konkursi dhe zhvillimi i konkursit.**

Dekani i Fakultetit të Shkencave të Edukimit siguron prezencën në punë të sekretareve mësimore në data e mëposhtme për regjistrimin e pjesëmarrësve në konkurs.


- a- Edukim Fizik e Sporte (Bachelor)      date 15, 16, 17, 18, 20 gusht 2018
- b- Pedagogji Muzikore (Bachelor)      date 14, 15, 16 gusht 2018
- c- Pikturë Grafikën (Bachelor)      date 14, 15, 16 gusht 2018

Datat e zhvillimit të konkurseve janë të përcaktuara si më poshtë:

- a- Edukim Fizik e Sporte (Bachelor)      date 22, 23 gusht 2018
- b- Pedagogji Muzikore (Bachelor)      date 17, 18 gusht 2018
- c- Pikturë Grafikën (Bachelor)      date 17. 18 gusht 2018

**6. Procedurat e renditjes dhe hartimit të listave në raundin e parë .**

- a- Me datë 10 gusht 2018 Fakulteti i Shkencave të Edukimit që zhvillon konkurse /testime pranimit afishon në mjediset e fakultetit dhe në faqen zyrtare të USH listat e aplikantëve që konkurrojnë për secilin program studimi.
- b- Nga data 23 deri 25 Gusht 2018 IT dhe personat përgjegjës shkarkojnë listat e aplikantëve nga portali U-Albania.
- c- Deri më datën 27 gusht 2018 komisionet e konkurseve shpallin rezultatet dhe renditjen e konkurrentëve pjesëmarrës në konkurs. Listat me rezultatet i dërgohen Rektorit të USH brenda orës 12:00 të datës 27 gusht 2018.
- d- Komisionet e departamenteve brenda datës 28 gusht 2018 bëjnë rankimin e aplikantëve të çdo dege sipas kriterëve të miratuara nga SA dhe afishojnë renditjen e kandidatëve. Në fund të listës, pas fituesit të fundit vendoset vijë e kuqe.

- 
- e- Brenda datës 28 gusht USH afishon dhe publikon në faqen zyrtare listat e renditjes së aplikantëve. Një kopje elektronike ngarkohet në portal U-Albania si dhe një kopje e tyre i dergohet QSHA brenda të njëjtës ditë. Afishimi bëhet duke përdorur si element identifikimi ID e aplikantit.

#### **7. Procesi i ankimit të aplikantëve në raundin e parë.**

a- Aplikantët kanë të drejtën e ankimit me shkrim në Fakultete, pranë sekretares së dekanit, në datën 29 gusht 2018.

b- Dekani i Fakultetit shprehet me vendim brenda 24 orëve nga paraqitja e çdo ankimi. Aplikanti që nuk është dakord me vendimin e Dekanit të Fakultetit ka të drejtën e ankimit në rrugë gjyqësore.

c- Fakultetet pas përfundimit të afatit të ankimit i përcjellin zyrtarisht rektorit brenda datës 30 gusht 2018 ora 12:00 vendimet lidhur me ankimet e aplikantëve.

d- USH pas përfundimit të afatit të ankimit dhe shqyrtimit të ankesave, pasqyron në format elektronik në portalin U-Albania brenda datës 31 gusht 2018 vendimet në lidhje me ankimet e aplikantëve.

e- Aplikantët, pavarësisht paraqitjes së ankesës, nëse janë shpallur fitues në një ose disa programe të tjera studimi, mund të vijojnë procedurat e regjistrimit. Nëse ankesa e tyre është e pranuar, ata duhet të reregjistrohen nga programi i studimit (nëse regjistruar) dhe të regjistrohen në programin e studimit, në të cilin është pranuar ankimimi, vetëm me datë 13 shtator 2018.

#### **8. Regjistrimi i fituesve në raundin e parë**

- a- Sekretaritë mësimore të fakulteteve të USH bëjnë regjistrimin e kandidatëve të shpallur fitues në listat përfundimtare të publikuara, duke filluar nga data 30 gusht deri me 12 shtator 2018 nga ora 8.00 - 16.30.
- b- Periudha e regjistrimit ndahet në 7 faza 48 orëshe. Fituesit duhet të paraqiten pranë sekretarisë së fakultetit përkatës për regjistrim brenda 48 orëve, ndryshe humbet të drejtën e regjistrimit në atë program.
- c- Regjistrimi i kandidatëve të shpallur fitues bazohet në udhëzuesin teknik të MASR.
- d- Regjistrimi vijon deri në plotësimin e kuotave. Kur konstatohen kuota të paplotësuara ato plotësohen duke ulur vijën e kuqe deri në plotësimin e kuotave. Fituesit e rinj mund të regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse.
- e- Aplikanti regjistrohet vetëm në një program studimi. Pas regjistrimit të aplikantit sekretaria mësimore e pasqyron regjistrimin edhe online në portalin U- Albania.
- f- Kandidatët fitues detyrohen të kryejnë regjistrimin online dhe regjistrimin me dokumente. Regjistrimi online i kandidatëve pranë sekretarive mësimore asistohet nga punonjësi i IT-së së USH. Sekretaritë mësimore pranojnë dokumente vetëm për kandidatët e shpallur fitues.
- g- Kandidatët fitues dorëzojnë dokumentet e përcaktuar në udhëzimin nr.18 date 21.05.2018 i MARS, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre. Dokumentet që duhet të paraqiten për regjistrim janë:  
Dokument identifikimi (fotokopja në dosje)  
fotokopje e noterizuar e diplomës së Maturës Shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë,

deklaratë sipas shtojcës 1 të udhëzimit, mandat pagese e tarifës së regjistrimit.

- h- Sekretaritetë mësimore të Fakultetit mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhëna mbi datën dhe orën e dorëzimit dhe nënshkrimin e kandidatit e regjistruar.
- i- Me date 14 shtator 2018 ora.12.00 fakultetet i përcjellin rektorit listën përfundimtare të kandidatëve të regjistruar në raundin e parë bashkë me kuotat e paplotësuara në format elektronik dhe hard copy.
- j- USH brenda datës 14 shtator 2018 i përcjell në QSHA dhe RASH regjistrimet përfundimtare të raundit të parë bashkë me kuotat e paplotësuara në format elektronik dhe hard copy.

#### **9. Çregjistrimi i studentëve të regjistruar në raundin e parë.**

- a- Aplikanti , pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacionin dhe ka nënshkruar në regjistër, ka të drejtë të çregjistrohet vetëm me datë 13 shtator 2018. Ai paraqet një kërkesë për çregjistrim pranë sekretarisë mësimore të fakultetit ku është regjistruar, duke tërhequr dokumentacionet e dorëzuara. Nëse nuk e kryen këtë brenda kësaj date, ai nuk ka të drejtë të ndryshoj programin e studimit për këtë vit akademik. Çregjistrimi kryhet në portalin U-Albania pranë sekretarisë mësimore të fakultetit.
- b- Sekretaritetë mësimore, pas çregjistrimit të aplikatëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, i dërgojnë QASHA-së dhe RASH-it, Brenda datës 14 shtator 2018, listën e aplikantëve të çregjistruar.

#### **10. Raundin e dytë i regjistrimeve.**

- a- Nga data 21-25 shtator 2018 Departamentet bëjnë përlllogaritjen e pikëve dhe përcaktojnë renditjen e aplikantëve të raundit të dytë duke përdorur si element identifikimi vetëm ID e tyre, në mënyrë që të respektohet mbrojtja e të dhënave personale. Brenda datës 25 shtator 2018, ora 12.00 , Dekani i Fakulteti afishon listat e renditjes së aplikantëve dhe i përcjell zyrtarisht një kopje elektronike të këtyre listave Rektorit të USH.
- b- Brenda datës 25 shtator 2018 USH afishon dhe publikon on-line listat e renditjes së aplikantëve për të gjitha programet e studimit dhe i përcjell zyrtarisht një kopje elektronike të këtyre listave QSHA-së dhe një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.

#### **11. Procesi i ankimit të aplikantëve në raundin e dytë.**

- a- Aplikantët kanë të drejtën e ankimit me shkrim në Fakultete , pranë sekretares së dekanit, në datën 26 shtator 2018. Brenda 24 orëve nga momenti i paraqitjes së ankesave Fakultetet duhet të shprehen me vendim lidhur me ankimet.
- b- Dekani i Fakultetit shprehet me vendim brenda 24 orëve nga paraqitja e çdo ankimi. Aplikanti që nuk është dakord me vendimin e Dekanit të Fakultetit ka të drejtën e ankimit në rrugë gjyqësore.

- SHKODER
- c- Fakultetet pas përfundimit të afatit të ankimit i përcjellin zyrtarisht rektorit brenda datës 28 shtator 2018 ora 12:00 vendimet lidhur me ankimet e aplikantëve.
  - d- USH përcjell zyrtarisht në QSHA, brenda datës 28 shtator 2018 vendimet në lidhje me ankimet dhe pasqyron brenda po kësaj date në portalin U-Albania këto vendime në format elektronik.
  - e- Aplikantët, pavarësisht paraqitjes së ankesës, nëse janë shpallur fitues në një ose disa programe të tjera studimi, mund të vijnë procedurat e regjistrimit. nëse ankesa e tyre është e pranuar, ata duhet të çregjistrohen nga programi i studimit (nëse regjistruar) dhe të regjistrohen në programin e studimit, në të cilin është pranuar ankimimi, vetëm me datë 7 tetor 2018.

## 12. Regjistrimi i fituesve në raundin e dytë.

- a- Sekretaritetë mësimore të fakulteteve të USH bëjnë regjistrimin e kandidatëve të shpallur fitues në listat përfundimtare të publikuara, duke filluar nga data 27 shtator – 6 tetor 2018 nga ora 8.00-16.30.
- b- Periudha e regjistrimit ndahet në 5 faza 48 orëshe. Fituesit duhet të paraqiten pranë sekretarisë së fakultetit përkatës për regjistrim brenda 48 orëve, ndryshe humbet të drejtën e regjistrimit në atë program.
- c- Regjistrimi i kandidatëve të shpallur fitues bazohet në udhëzuesin teknik të MASR.
- d- Regjistrimi vijon deri në plotësimin e kuotave. Kur konstatohen kuota të paplotësuara ato plotësohen duke ulur vijën e kuqe deri në plotësimin e kuotave. Fituesit e rinj mund të regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse.
- e- Aplikanti regjistrohet vetëm në një program studimi. Pas regjistrimit të aplikantit sekretaria mësimore e pasqyron regjistrimin edhe online në portalin U- Albania.
- f- Kandidaten fitues detyrohen të kryejnë regjistrimin online dhe regjistrimin me dokumente. Regjistrimi online i kandidatëve pranë sekretarive mësimore asistohet nga punonjësi i IT-së së USH. Sekretaritetë mësimore pranojnë dokumente vetëm për kandidatët e shpallur fitues.
- g- Kandidatët fitues dorëzojnë dokumentet e përcaktuar në udhëzimin nr.18 date 21.05.2018 i MARS, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre. Dokumentet që duhet të paraqiten për regjistrim janë: Dokument identifikimi (fotokopja në dosje) fotokopje e noterizuar e diplomës së Maturës Shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë, deklaratë sipas shtojcës një të udhëzimit, mandate pagesën e tarifës së regjistrimit.
- h- Sekretaritetë mësimore të Fakultetit mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhëna mbi datën dhe orën e dorëzimit dhe nënshkrimin e kandidatit e regjistruar.
- i- Me datë 12 tetor 2018 ora 12.00 fakultetet i përcjellin rektorit listën përfundimtare të kandidatëve të regjistruar në raundin e dytë bashkë me kuotat e paplotësuara në format elektronik dhe hard copy.
- j- USH brenda datës 22 tetor 2018 i përcjell në QSHA dhe RASH regjistrimet përfundimtare të raundit të dytë bashkë me kuotat e paplotësuara në format elektronik dhe hard copy.

### 13. Çregjistrimi i studentëve të regjistruar në raundin e dytë.

- a- Aplikanti , pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacionin dhe ka nënshkruar në regjistër, ka të drejtë të çregjistrohet vetëm me date 7 tetor 2018. Ai paraqet një kërkesë për çregjistrim pranë sekretarisë mësimore të fakultetit ku është regjistruar, duke tërhequr dokumentacionet e dorëzuara. Nëse nuk e kryen këtë brenda kësaj date, ai nuk ka të drejtë të ndryshoj programin e studimit për këtë vit akademik. Çregjistrimi kryhet në portalin U-Albania pranë sekretarisë mësimore të fakultetit.
- b- Sekretaritë mësimore , pas çregjistrimit të aplikatëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, i dërgojnë QASHA-së dhe RASH-it, brenda datës 9 tetor 2018, listën e aplikantëve të çregjistruar.

### 14. Procesi i regjistrimit në raundin e tretë.

#### a. Regjistrimi

Procesi i regjistrimit në raundin e tretë zgjat nga data 9-13 tetor 2018.

Nga data 9-13 tetor 2018 vijojnë regjistrimet e kandidatëve që kanë aplikuar në raundin e parë dhe të dytë. Regjistrimet behën nëpërmjet portalit U-Albania.

Të drejtën e regjistrimit në raundin e tretë e kanë kandidatët që nuk rezultojnë të regjistruar në një program studimi. Regjistrimi behet nga data 9-13 tetor 2018 në përputhje me numrin e kuotave.

Sekretaritë mësimore në procesin e regjistrimit të kandidatëve detyrohen të zbatojnë renditjen e kandidatëve në raundin e dytë deri në plotësimin e kuotave. Për kuotat e paplotësuar zhvendoset vija e kuqe.

#### b. Plotësimi i kuotave

Në rast se përfundon e gjithë lista e kandidateve që kanë aplikuar në raundin e dytë dhe mbeten kuota të paplotësuara në programet përkatëse të studimit, nga data 15-18 tetor 2018 , njësitë bazë përzgjedhin kandidatët fitues sipas kërkesave të depozituara nga kandidatët që nuk rezultojnë të regjistruara në një program tjetër studimi.

#### c. Renditja

Me datë 18 tetor 2018 kandidatët që aplikojnë përzgjidhen dhe renditen nga njësitë baze përkatëse dhe miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, dekani. Lista e kandidatëve fitues shpallet në faqen zyrtare të USH, në mjediset e Fakulteteve si dhe ngarkohet një kopje elektronike të ketyre listave ne portalin U-Albania.

#### d. Regjistrimi

Regjistrimi i kandidatët të shpallur fitues do të bëhet pranë sekretarive mësimore nga data 19-20 tetor 2018.

Për regjistrimin e kandidatëve duhet të paraqesin në sekretarinë mësimore dokumentet e regjistrimit të përcaktuara në Udhëzimin nr 18 datë 21.05.2018 te Ministrisë Arsimit, Sportit dhe Rinise pika c germa 7.

SHKODËR


Brenda datës 26 tetor 2018 Fakultete përcjellin në Rektorat regjistrimet përfundimtare të raundit të tretë në format elektronik dhe hard copy.

Brenda datës 29 tetor 2018 USH përcjell në QSHA regjistrimet përfundimtare të raundit të tretë në format elektronik dhe hard copy

**15. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë**

**REKTORI**

**Prof. dr. Adem BEKTESHI**



*Adem Bekteshi*